

**VENDIM**  
**Nr.660, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË  
DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,  
KOMUNA ANTIGONE TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Antigone të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Antigone për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE**

(Mbështetur ne inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

| Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU |                                 |                                                 |                                                              |                  |              |                  |                                       |                                                  |                                                           |                                        |
|-----------------------------------------|---------------------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|------------------|--------------|------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| Komuna: <b>Antigone</b>                 |                                 |                                                 |                                                              |                  |              |                  |                                       |                                                  |                                                           |                                        |
| Nr                                      | Numri i pronës sipas inventarit | Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK) | Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore) | Numri i ngastrës | Destinacioni | Sipërfaqja në ha | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni, enti përdoues, statusi juridik i përdorimit | Të dhena të tjera (shënime të veçanta) |
| 1                                       | 1                               | EP Lunxheri                                     | Shkemb i Manastirit                                          | 78/a             | P.Prodhues   | 27.6             | LP+DZ                                 | MMPAU                                            | Komuna                                                    |                                        |
| 2                                       | 2                               | "                                               | Shkemb i Manastirit                                          | b                | Shkemb       | 7                | Shkemb                                | "                                                | "                                                         |                                        |
| 3                                       | 3                               | "                                               | Kemba e Zografes                                             | 79               | P.Prodhues   | 44.2             | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 4                                       | 4                               | "                                               | Lisare e Manastirit                                          | 80               | P.Prodhues   | 23               | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 5                                       | 5                               | "                                               | Kemba e Shendellise                                          | 81               | P.Prodhues   | 53.3             | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 6                                       | 6                               | "                                               | Rapse perroi i mullirit                                      | 82               | P.Prodhues   | 18               | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 7                                       | 7                               | "                                               | Faqe e Krinise                                               | 83               | P.Prodhues   | 10.3             | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 8                                       | 8                               | "                                               | Faqe e Krinise                                               | 84               | P.Prodhues   | 19               | LP+DZ                                 | "                                                | "                                                         |                                        |
| 9                                       | 9                               | "                                               | Sotirioka                                                    | 85               | P.Prodhues   | 26               | Dru zjarri                            | "                                                | "                                                         |                                        |
| 10                                      | 10                              | EK Lunxheri                                     | Kucupe                                                       | 35               | K.Dimerore   | 74               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 11                                      | 11                              | "                                               | Koder e madhe                                                | 40               | K.Dimerore   | 20               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 12                                      | 12                              | "                                               | Laro                                                         | 42               | K.Dimerore   | 54               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 13                                      | 13                              | "                                               | Kemba e Fierit                                               | 52               | K.Dimerore   | 118              | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 14                                      | 14                              | "                                               | Mali i Polonecit                                             | 52/a             | K.Dimerore   | 54               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 15                                      | 15                              | "                                               | Gjinoreshat-kokedhen                                         | 61               | K.Dimerore   | 80               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 16                                      | 16                              | "                                               | Gropa e ariut                                                | 34               | K.Dimerore   | 69               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 17                                      | 17                              | "                                               | Mali Polonice                                                | 53               | K.Verore     | 230              | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 18                                      | 18                              | "                                               | Gropa e Dacit                                                | 54               | K.Verore     | 301              | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |
| 19                                      | 19                              | "                                               | Jerme                                                        | 59               | K.Dimerore   | 36               | Kullote                               | "                                                | "                                                         |                                        |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Antigone

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendore të pronave<br/>në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b> | <b>Lloji i transferimit</b> |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------|
| <b>1</b>                                                    | <b>2</b>                            | <b>3</b>                    |
| 1-19                                                        | Pyll, kullota e sipërfaqe të tjera  | Në pronësi                  |
|                                                             |                                     |                             |
|                                                             |                                     |                             |
|                                                             |                                     |                             |